



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 274 / Prot
2

Rrëshen më, 30 . 01 . 2026

V E N D I M

Nr. 6 datë 26. 01. 2026

PËR

**“MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT DHE PARASHIKIMEVE AFATMESËM
TË TË ARDHURAVE 2027 – 2029”, BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", ligji nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 26.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në Raportin nr. 274 prot, datë 16.01.2026, "Mbi vlerësimin dhe parashikimeve afatmesëm të të ardhurave 2027-2029" Bashkia Mirditë, së bashku me projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, shqyrtimin e miratimit në mbledhjen e datës 23.01.2026, të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit, për t'a kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë raportin e vlerësimit dhe parashikimeve afatmesëm të të ardhurave 2027-2029, Bashkia Mirditë, së bashku me raportin nr. 274 prot, datë 16.01.2026, "Mbi vlerësimin dhe parashikimeve afatmesëm të të ardhurave 2027-2029" Bashkia Mirditë, bashkëlidhur, pjesë përbërse e këtij vendimi
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë; (Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICAKU



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË

Nr. 274/1 Prot

Rrëshen më, 16 . 01 . 2026

P/V E N D I M

Nr. 6 datë 16 . 01 2026

PËR

“MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT DHE PARASHIKIMEVE AFATMESËM TË TË ARDHURAVE 2027-2029”

Mbështetur në ligjin 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, në ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore “(i ndryshuar), në ligjin Nr.9920 datë 26.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH “(i ndryshuar), të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, këshilli i bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë:

V E N D O S I :

- I. Të miratojë raportin e vlerësimit dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave për vitet 2027 - 2029.
- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë (Drej.Zhv.Ek.Tat.Taksave).
- III. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

KRYETARI

Gaspër TOPOLLAJ

Aleksandër PICAKU

Paraqitën Projektin

P/Sek.Tatim – Taksa;

E.Vuka

D/Zhv.Ekonomik;

V. Gjoka

Përgj.Sek.juridik & prokurimeve M.Topollaj

KRYETARI

Albert MËLYSHI



ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel&fax :+3552162223 web:www.bashkiamirdite.gov.al



BASHKIA MIRDITË

Nr. 274 Prot.

Rrëshen, më 16.01.2026

RAPORTI I VLERËSIMEVE DHE PARASHIKIMEVE AFATMESME TË TË
ARDHURAVE 2027-2029
BASHKIA MIRDITË

Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave

Të ardhurat e veta përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës nga burimet qendrore. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifat është i mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Mirditë e hartuar dhe miratuar në nëntor 2025, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë. Vlen të theksohet se planifikimi afatmesëm mbart riskun e ndodhjes apo jo të ngjarjeve të parashikuara dhe kjo ndikon në saktësinë e plotë të planit afatmesëm.

Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Ajo paraqet në detaje çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcakton qartë edhe administrimin e saj duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj.

Paketa fiskale e Bashkisë Mirditë për këtë kategori e hartuar dhe e ndryshuar edhe me përfshirjen e përfaqësuesve të komunitetit të biznesit e më konkretisht biznesit të madh dhe të vogël, banorëve të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit, këshilltarë etj., pasqyron disa politika të rëndësishme për uljen e disa niveleve ligjore/kufi, etj. sipas kompetencave ligjore, si më poshtë:

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al



Politikat lehtësuese në taksat vendore sipas kufinjve ligjor:

- Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime banimi në 30% nga referenca ligjore
- Taksë banese zero për pensionistët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike
- Ulje deri në nivelin minimal ligjor për taksën e ndikimit në infrastrukturë

Këto politika janë hapësirë e përcaktuar me ligj që mund të miratohet me VKB.

Politikat lehtësuese dhe uljet nën nivelet e kostos së shërbimit të llogaritur:

- Tarifa zero për shërbimin e gjelbërimit për zonat rurale ku nuk merret ky shërbim.
- Tarifa zero për shërbimin e ndriçimit publik në zonat rurale ku nuk merret ky shërbim nga banorët.
- Tarifa të reduktuara në krahasim me familjet normale sipas kritereve për pensionistët e vetmuar, kategorinë invalidë, kryefamiljarët (burra/gra) të vetëm me fëmijë të mitur etj.
- Tarifa zero për fermerët që janë regjistruar me NIPT nga Drejtoria Tatimore për 5 vitet e para të aktivitetit
- Tarifa të ulëta pastrimi (të përballueshme nga subjektet sipas llojit të aktivitetit, po ashtu dhe për kategorinë familje sipas zonës dhe statusit)

Procesi i planifikimit të të ardhurave të veta u realizua në bashkëpunim me administratën e bashkisë, me Njësitë Administrative, me Institucionet e Agjentët tatimorë, etj. Vazhdimi i këtij procesi bashkëpunues do të mundësojë sigurimin e të ardhurave, me efekt përmirësimit e mëtejshëm të infrastrukturës në vend dhe shërbimit ndaj qytetarit.

Zërat e taksave dhe tarifave që ndikojnë pjesën më të madhe të planit të të ardhurave nga burimet e veta janë kryesisht tarifat për pastrimin të tij, taksa e pasurisë së paluajtshme dhe e ndikimit në infrastrukturë. Nga taksat e transferuara nga institucionet e tjera (taksat e ndara) përmendim taksa e mjeteve të përdorura dhe tatimi i të ardhurave personale që kanë një vlerë të konsiderueshme.

Tabela e mëposhtme pasqyron planin e të ardhurave të veta, të kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik ligjor: shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorin e bashkisë.

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat, të ardhurat nga tarifat dhe të ardhurat nga burime të tjera që lindin nga shërbime të ndryshme të bashkisë.

Tabela 1 Të ardhurat e veta të Bashkisë Mirditë

	I pritshmi 2026	Plani 2027	Plani 2028	Plani 2029
Të ardhurat e veta	88 131 000	89 141 000	92 421 000	92 421 000

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel & fax : +355 216 22233

web: www.bashkiamirdite.gov.al

Të Ardhura nga Taksat Vendore	32 379 000	32 429 000	32 429 000	32 429 000
Të Ardhura nga Taksat e Ndara	22 012 000	22 012 000	24 012 000	24 012 000
Të Ardhura nga Tarifatat Vendore	26 100 000	26 100 000	27 200 000	27 200 000
Të Ardhura të tjera	7 640 000	8 600 000	8 600 000	8 600 000

Në totalin e tij si plan, është bërë analiza dhe në vitin 2025 për periudhën 2025-2028. Plani 2026-2029 parashikohet pa ndryshime gjatë viteve, gjithashtu një mosndryshim në vlera planifikimit për vitin 2029 në vetvete. Gjatë këtyre viteve është parë një ritëm i dyndjes masive të popullsisë drejt qyteteve të mëdha dhe emigrimit jashtë vendit dhe një ritëm i mbylljes së bizneseve. Ky trend i rënies së aktiviteteve dhe popullsisë u vërejt dhe gjatë vitit 2025. Nëse popullsia do vazhdojë me këtë ritëm emigrimi, për vitin 2026 e në vazhdim parashikohet që taksa nga pasuritë e paluajtshme të mos mbledhet 100% pavarësisht se objektet dhe pasuritë janë ekzistuese dhe gjatë vitit 2026 do të bëhet saktësimi i tyre deri në identifikim të plotë sipas ligjit të ri dhe punës me Kadastrën Fiskale. Kështu do rritet vlera në zërin e debitorëve. E njëjta situatë parashikohet dhe për periudhën afatmesme për vitet 2027 deri 2029, me shpresën për të mos patur më shumë rënie të popullsisë në Mirditë.

Të ardhurat nga taksat e ndara janë në rritje për shkak se numri i mjeteve që përdoren për transport vetjak është çdo vit e më i lartë. Numri i automjeteve për familjet ekzistuese është gjithmonë e në rritje. Kjo duket sikur bie në kundërshtim me rënien e numrit të popullsisë, por nga të dhënat e koordinuara me DRSHTRR shihet një rritje e numrit të mjeteve të përdorura. Ndryshimi i kufirit të tatimit në ligjin mbi tatimin e të ardhurave personale, mendohet dhe parashikohet që do ketë ndikim pozitiv dhe në të ardhurat që i takojnë Bashkisë Mirditë për këtë lloj tatimi.

Të ardhurat nga tarifatat pjesa më e madhe ndikohen drejtpërdrejt nga shërbimet që vetë bashkia kryen. Duke qenë se bashkitë janë institucione edhe me vetëfinancim, domosdoshmërisht janë të varura nga taksat dhe tarifatat që paguhen. Që të ketë sa më shumë shërbime është e natyrshme që dhe tarifatat duhet të rriten. Aktualisht bashkia operon me disa shërbime (si pastrimi, ndriçimi dhe gjelbërimi). Edhe këtë vit, pavarësisht një organizimi të ri të tarifës së pastrimit, bashkia operon në kryerjen e shërbimeve si detyrim ndaj qytetarëve dhe bizneseve nën kosto. Në mënyrë që këto shërbime dhe të tjera të mbulohen nga vetë bashkia, është e detyrueshme që në vitet në vazhdim të ketë ndryshime të vogla sipas nevojës së shërbimit për rritje normale të tarifave. Mëposhtë do specifikojmë në mënyrë më të detajuar parashikimin afatmesëm të zërave kryesorë të të ardhurave të Bashkisë Mirditë për periudhën 2026-2029.

Tabela 2 Të ardhurat e veta ndër vite dhe parashikimi 2026-2029



në mijë lekë

LLOJET E TË ARDHURAVE		I Pritshmi 2026	Plan 2027	Plan 2028	Plan 2029
	TË ARDHURAT E VETA	88131	89141	92421	92421
I	NGA TAKSAT VENDORE	32379	32429	32429	32429
1	Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	9900	9900	9900	9900
2	Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	150	150	150	150
3	Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet	2500	2550	2550	2550
4	Takse tabele	2329	2329	2329	2329
5	Taksa të tjera	17500	17500	17500	17500
II	NGA TAKSAT E NDARA	22012	22012	24012	24012
1	Të ardhura nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	12000	12000	13000	13000
2	Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale	10000	10000	11000	11000
3	Të ardhura nga renta minerare	12	12	12	12
III	NGA TARIFAT VENDORE	26100	26100	27200	27200
1	Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	17000	17000	18000	18000
2	Leje transporti	700	700	800	800
3	Tarifa të përkohshme	8400	8400	8400	8400
IV	TË TJERA	7640	8600	8600	8600
1	Të ardhura sekondare	4000	5000	5000	5000
2	Të ardhura nga çerdhja dhe kopshti	3640	3600	3600	3600
3	Kontratë Seka Hydropower				

Në tabelën e mësipërme të ardhurat janë të ndara nga taksat vendore deri në kategorinë e tarifave të tjera. Taksat vendore janë taksa që i menaxhon bashkia duke ju bazuar legjislacionit në fuqi. Taksat e ndara janë taksa që shpërndahen nga institucione palë e tretë për llogari të bashkisë sipas përqindjeve që përcaktohen me ligj.

Kategoria e taksave vendore nuk parashikon të ketë ndryshime të mëdha. Siç shihet dhe nga tabela e mësipërme pritet që taksa e pasurisë parashikohet në të njëjtat vlera. Kjo për arsye se pavarësisht identifikimit të pasurive, nuk mendohet që arkëtimi të jetë shumëllojës ndryshëm gjatë këtyre viteve si pasojë e largimeve masive. Vihet re nga tabela një rritje e taksës së ndikimit në infrastrukturë përse i përket kategorisë së taksave të veta, edhe pse jo në vlera të mëdha. Kjo rritje parashikohet të jetë nga

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel & fax : +355 216 22233

web: www.bashkiamirdite.gov.al



punimet dhe rikonstruksionet e ndryshme në objektet ekzistuese.

Një rritje jo të lartë mendohet të ketë dhe në taksat e ndara pikërisht për taksën e regjistrimit të mjeteve të përdorura dhe taksën e të ardhurave personale. Kjo vjen si rezultat i prirjes deri në ditët e sotme të rritjes në numrit të makinave të regjistruara në territorin e Bashkisë Mirditë dhe shtimit të profesioneve të lira dhe ndryshimit të kufirit ligjor për të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale.

Kapacitetet fiskale të taksapaguesve

Taksapaguesit familjarë

Paguesit e taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjitha njësive administrative. Për përcaktimin e numrit të tyre janë konsideruar të dhënat e regjistrave për taksapaguesit, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të miratuar nga këshilli bashkiak. Në total numri i familjeve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë Mirditë sipas regjistrit të gjendjes Civile është 11,031. Nga verifikimet në terren nga inspektorët e sektorit të tatim-taksave numri i familjeve për vitin 2026 është 5394 familje.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse e kapacitetit të taksapaguesve sipas kategorive dhe njësive administrative për familjarët.

Nr	Njesitë Administrative	Nr familjeve GJC	Nr.familjeve Te verifikuara
1	Njësia Administrative Rreshën	4542	2415
2	Njësia Administrative Rubik	2565	1120
3	Njësia Administrative Orosh	976	403
4	Njësia Administrative Fanë	1268	695
5	Njësia Administrative Kaçinar	283	191
6	Njësia Administrative Kthellë	1222	395
7	Njësia Administrative Selitë	175	175

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel & fax : +355 216 22233

web: www.bashkiamirdite.gov.al

GRAFIKU SIPAS NJËSIVE

- Njësia Administrative Rreshën ■ Njësia Administrative Rubik ■ Njësia Administrative Orosh
- Njësia Administrative Fanë ■ Njësia Administrative Kaçinar ■ Njësia Administrative Kthellë
- Njësia Administrative Selitë



Numri i familjeve që përfitojnë lehtësira fiskale është 623 familje përsa i përket tarifave vendore ku përfshihen pastrimi, ndriçimi dhe gjelbërimi. Familjet me ndihmë ekonomike dhe pensionistët që përjashtohen nga taksa e ndërtesës janë 514 familje.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet dhe përqindja nga totali i familjeve gjithsej sipas të dhënave më lart.



Raporti i taksapaguesve sipas grupimeve është si mëposhtë:

Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke ju referuat kapaciteteve reale të familjeve rezidente ne territorin e bashkisë.

Në planin e të ardhurave janë parashikuar lehtësirat fiskale për familjet me probleme sociale, si dhe përfamiljet që janë përfitues te ndihmës ekonomike, për pensionistët, për invalidët etj të paraqitura mësipër.

Taksapaguesit biznese dhe institucione

Bazuar në rregjistrat aktual, në total, numri i bizneseve dhe institucioneve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë Mirdite është 390 biznese gjithsej. Krahasuar me vitet e mëparshme biznesi i vogël në fillim të vitit 2026 përbëhet nga 311 biznese. Biznesi i madh ka një numër prej 79 biznesesh. Në krahasim me vitin e mëparshëm janë shtuar biznese me karakter të profesioneve të lira si konsulentë ligjor, ushqimor apo websajtesh.

Mëposhtë po paraqesim grafikisht dhe përqindjen që zënë këto kategori nga totali i tyre.



Siç shihet dhe grafikisht, përqindjen më të madhe e zë numri i biznesit të vogël, ku aktivitetin kryesor e mbizotëron kategoria tregti dhe shërbime. Këtu përfshihet marketet e ndryshme ose tregtimi i mallrave industriale dhe shërbimet si parukeritë, bar-kafetë apo konsulencia të ndryshme.

Përsa i përket aktivitetit të biznesit në përgjithësi, pesha specifike e kategorive të bizneseve paraqitet si mëposhtë:

-Karburante	3%
-Hec	3%
-Nyje inerte	1.4%
-Restorante	3%
-Bar-Kafe	15%
-Farmaci	2%
-Market	11%
-Sallone bukurie	2%



- Profesione te lira 1%
- Shfrytzim kromi 1.4%

Kapaciteti i pronës së taksueshme

Bazuar në rregjistrat aktual, në total, sipërfaqja ndërtesave që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të Bashkisë Mirdite është si mëposhtë sipas biznesit i madh apo i vogël. Duhet të theksojmë se për kategorinë e bizneseve nuk ka përjashtime e lehtësira fiskale për pasurinë paluajtshme.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse për sipërfaqet e taksueshme në m² të ndërtesave në pronësi të bizneseve dhe për ato që ushtrojnë aktivitetin e tyre në objekte me qira.

Kapaciteti i ndërtesave të biznesit, sipas kategorizimit të pronës

Nr	Bashkia	Total Sipërfaqe ndërtesa biznesi m ²	Nga kjo :	
			Sip e taksueshme biznesi në pronësi të vet	Sipërfaqe e taksueshme biznesi me qira
I	B Mirditë	59,649	54,987.64	4,661.36

Kapaciteti i banesave të taksueshme

Nr	Bashkia	Total sipërfaqe per familjet ndërtesa banimi m ²
I	Mirditë	318,600

Kapaciteti i truallit të taksueshëm, sipas kategorizimit të taksës në m²

Nr	Bashkia	Total trualli taksueshëm, m ²	Sipërfaqe taksapagues familjar, m ²	Truall taksapagues biznes, m ²
I	Mirditë	846,220	721,330	124,890

Kapaciteti i tokës bujqësore të taksueshme në m²

Nr	Bashkia Mirdite	Kat I	Kat II	Kat III	Kat IV	Kat V	Kat VI	Kat VII- X
----	-----------------	----------	-----------	------------	-----------	----------	-----------	---------------

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel & fax : +355 216 22233

web: www.bashkiamirdite.gov.al

I	Mirditë	-	-	-	-	-	-	9,600,900
---	---------	---	---	---	---	---	---	-----------



Detajimi e të ardhurave sipas zërave, pesha tek të ardhurat e bashkisë

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, të ardhura nga taksat e ndara, nga tarifat vendore, dhe të ardhurat e tjera.

Sipas ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/2, bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimit të tyre brenda kufijve e sipas kriterëve të përcaktuara me ligj.

Llogaritja e të ardhurave të kësaj kategorie mbështetet në:

1. Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar;
2. Ligjin nr.9920 datë 26.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" indryshuar ;
3. Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.94 date 26.11.2025 "Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Mirditë

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel & fax : +355 216 22233

web: www.bashkiamirdite.gov.al



Të ardhurat nga taksat vendore

Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", me ndryshimet përkatëse, përbën ligjin bazë i cili përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të taksave vendore, mbledhjes dhe administrimit të tyre.

Pjesë e rëndësishme në këtë kategori të taksave vendore janë:

Të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Të ardhurat nga taksat e ndara

Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë

Të ardhurat nga qiraja e fondit pyjor



Të ardhura nga Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Këto të ardhura përfshijnë të ardhurat nga :

- Taksa mbi ndërtesat (mbi ndërtesat e banimit dhe mbi ndërtesat e tjera)
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

Parashikimi për vitet 2026-2029 bazohet te saktësimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- Saktësimi dhe vlerësimi të drejtë të sipërfaqeve nëpërmjet grupeve të punës të ngritura për këtë qëllim,
- Ndarjes në këste të pagesave për bizneset
- Shtrirje e mëtejshme e bazës taksapaguese, falë politikave fiskale lehtësuese dhe incentivave të ndërmarra, rivlerësimit të gjendjes faktike, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, si dhe bashkëpunimit të pritshëm me institucione si ZRRPP, ALUIZNI etj.

Pavarësisht këtyre politikave, Bashkia Mirditë po has përditë e më shumë riskun e largimit të banorëve nga vendi i tyre dhe kemi një ulje të numrit të popullsisë e parë faktikisht. Kjo po ndikon dhe në të ardhurat e fituara nga taksa e pasurisë dhe mendohet të mos ketë rritje dhe për vitet në vazhdim.

Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel

Kjo taksë administrohet nga Bashkia Mirditë. Me "Hotel" kuptohet çdo subjekt tregtar që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel për person, dhe përcaktohet me ligj. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes, dhe mbi të vlera e taksës.

Planifikimi i të ardhurave për këtë taksë është në të njëjtin nivel pasi kjo lloj takse është disi e lidhur drejtpërdrejt me turizmin dhe turizmi më zonën e Mirditës në pjesën më të madhe të periudhave është ditor me shpresën që në një kohë më afatgjatë të shohim ndryshime pozitive dhe të ketë dhe rritje të turizmit dhe për pasojë dhe të kësaj takse.

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel & fax : +355 216 22233

web: www.bashkiamirdite.gov.al



Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë

Edhe taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja administrohet nga Bashkia Mirditë.

Bazuar në ligjin 9632, taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja është përlllogaritur duke marrë për bazë Planin e Përgjithshëm Vendor, miratuar me vendimin e KKT nr.5 datë 16.10.2017 “ Për miratimin e planit të përgjithshëm vendor, Bashkia Mirditë”. Bazuar në ligjin Nr. 9482 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, taksa për ndërtesat në proces legalizimi llogaritet 0,5% e vlerës së investimit.

Plani i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë bazohet mbi parashikimin e lejeve për ndërtime të reja dhe shlyerjen e detyrimeve për objektet në proces legalizimi dhe punimeve dhe rikonstruksioneve që bëhen mbi objektet ekzistuese.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet në proces legalizimi administrohet nga Bashkia Mirditë. Vjelja e kësaj takse paraqet vështirësi për Bashkinë Mirditë, për arsye se subjektet dhe familjarët pasi kryejnë procedurat e legalizimit pranë ALUIZNI-it, arrijnë të kryejnë regjistrimin e pronës pa shlyer detyrimin përkatës. Realizimi i ardhurave nga kjo taksë lidhet dhe bazohet në zbatimin e masave shtrënguese, bllokimin e shërbimit të debitorëve nga Bashkia Mirditë, si dhe në mbështetjen nga ZRRPP-ja. Gjithsesi, për periudhën 2026-2029 parashikohet të ketë një rritje të nivelit të kësaj takse nga rikonstruksionet e ndryshme që bëjnë familjet në pasuritë ekzistuese të tyre.

Të ardhura nga Taksa e Tabelës

Bazuar ne Ligjin Nr. 9632, dt.30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore”, taksa e tabelës aplikohet për tre lloje tabelash, të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes së tyre:

Tabela për qëllime identifikimi, të cilat nëse janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi. Tabelat me sipërfaqe më të vogël se 2 m² nuk taksohen.

Tabela për qëllime reklamimi, ku përfshihen tabelat që nuk janë brenda territorit të biznesit ose nuk janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës, dhe që mund të jenë të thjeshta ose elektronike.

Tabela për qëllime ekspozimi, ku përfshihen tabelat me karakter të përkohshëm, për ekspozime të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel & fax : +355 216 22233

web: www.bashkiamirdite.gov.al



Taksa e tabelës për vitin 2025 në krahasim me vitet e mëparshme ka patur rritje pasi janë bërë identifikime të tabelave të vendosura te vetë bizneset. Duke qenë se pjesa më e madhe e identifikimit të tyre është bërë, për vitet në vahdim, duke qenë në sinkron dhe me rënien e numrit të bizneseve, nuk mendohet që do ketë rritje të taksës së tabelës.

Të ardhurat nga Taksat e Ndara

Të ardhurat nga taksat e ndara bazohen në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 25, Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin një përqindje nga taksat ose tatimet kombëtare që realizohen në juridiksionin e tyre. Taksat kombëtare që ndahen me njësitë e vetëqeverisjes vendore janë:

- a) Të ardhurat nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë personat fizikë dhe juridikë
- b) Të ardhurat nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura;
- c) Të ardhurat nga renta minerare, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për taksat kombëtare
- d) Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale

Sipas ligjit, të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara transferohen te njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në fund të muajit pasardhës.

Të ardhura nga Taksa e regjistrimit të mjeteve të përdorura

Bazuar në ligjin 9975 dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” të ndryshuar përcaktohet administrimi i taksës kombëtare të regjistrimit të mjeteve të përdorura, ku pas arkëtimit nga institucione shtetërore në rolin e agentëve tatimorë, një pjesë e këtyre të ardhurave transferohen në buxhetin e njësitë të qeverisjes vendore sipas përkatësisë nga burojnë.

Referuar pikës 3, të Nenit 4 të Ligjit 9975, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor, arkëton detyrimin nga pronari i mjetit për vlerën e taksës për automjetin, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara, 25% e të ardhurave nga kjo taksë kalon për llogari të Bashkisë.

Planifikimi i të ardhurave bëhet referuar numrit të automjeteve si dhe bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara rereferuar të dhënave për nivelet e arkëtimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor dhe për vitet 2026-2029 siç u përmend dhe mësipër, duke parë trendin e rritjes së makinave të përdorura mendohet të ketë një rritje të kësaj takse.



Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Kjo taksë administrohet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Taksa me nivelet sipas Ligjit Nr.9632 paguhet para kryerjes së regjistrimit, nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, dhe vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agentit tatimor përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar, ndërsa diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të Bashkisë Mirditë, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Planifikimi bëhet bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara dhe rereferuar numrit të procedurave të tjetërsimit të pronës të kryera nga agjenti tatimor. Gjatë vitit 2025 ka patur një arkëtim diferencues në krahasim me vitet e mëparshme. Duke përditësuar të dhënat për pasuritë në bashkëpunim me zyrat noteriale mbi shitjen e banesave, pritët të ketë një arkëtim të kësaj takse në përqindje të pranueshme. Kjo për arsye të përditësimit të ligjit për pasurinë e paluajtshme dhe kalimit të detyrimeve nëpërmjet e-albanias.

Të ardhura nga Taksa e Rentës minerare

Bazuar në nenin 4 i ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për Taksat Kombëtare" i ndryshuar, baza e taksës së rentës minerare llogaritet mbi burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Personi fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës përkonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, (5%) e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Mirditë në llogarinë e degës së thesarit.

Planifikimi i të ardhurave i referohet realizimit të të ardhurave ndër vite që ka qenë në vlera krejtësisht të ulëta. Dhe për vitet në vazhdim mendohet të mbetet po e njëjta vlerë për shkak të mos shpërndarjes në mënyrë të drejtë nga instanca më të larta dhe pse bashkia ka subjekte të konsiderueshme që janë pjesë e taksës së rentës minerare.

Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel & fax : +355 216 22233

web: www.bashkiamirdite.gov.al



Bazuar në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 25, Pika 2, të ardhurat e arkëtuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore për tatimin mbi të ardhurat personale do të ndahet me njësitë e vetëqeverisjes vendore, dhe 2% e të ardhurave nga kjo taksë kombëtare i kalon përkatësisht Bashkisë Mirditë në llogarinë e degës së thesarit.

Planifikimi i të ardhurave i është referuar të dhënave statistikore për të punësuarit në territorin e bashkisë dhe duke parë ndryshimin e kufirit ligjor për të ardhurat personale në vitin 2024, parashikohet një rritje e kësaj takse.

Të ardhura nga Taksa për zënie e hapësirave publike

Baza e taksës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në m² e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi, në varësi të kohës së shfrytëzimit.

Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar kërkesës në rritje për shfrytëzimin e hapësirave publike brenda juridiksionit të Bashkisë duke parë dhe ndryshimin për një rritje me 200 lekë/m² nga vitet e mëparshme për vitet në vazhdim. Kjo taksë është e përfshirë te kategoria e taksve të tjera në tabelën e mësipërme e të ardhurave.

Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë

Te ky zë parashikohen të ardhurat nga qira të bazuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar. Pasuritë që jepen me qira janë ndërtesat, trualli i lirë, trualli i lirë funksional (jo nën ndërtesë), makineritë e pajisjet dhe linjat e prodhimit. Bashkia Mirditë ka të lidhura disa lloje kontratash me subjekte të ndryshme për ndërtim HEC-esh, Për sipërfaqe trualli për vendosjen e antenave të kompanive celulare, për agroturizëm, për kullota etj. Parashikimi i bërë për vitin 2026 në bazë të kontratave ekzistuese dhe afateve të tyre është në vlerën 15,014,632 lekë. Edhe parashikimi i tyre për vitet 2026-2029, bëhet në bazë të kontratave që mendohet se mund të lidhen gjatë viteve në vazhdim dhe nqs ka kontrata ekzistuese për rinovimin e tyre.

Të ardhurat nga Tarifat Vendore

Referuar ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 35/5, bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifat vendore për: shërbimet publike që ato ofrojnë; të drejtën e përdorimit të pronave publike

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel & fax : +355 216 22233

web: www.bashkiamirdite.gov.al



vendore; dhënie e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj. Gjithashtu bashkitë mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive, dhe të tjera, të përcaktuara me ligj.

Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikat dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi.



Kriteri bazë për vendosjen e një tarife për shërbimin publik është kostoja e tij, e cila shpërndahet dhe paguhet nga familjet dhe bizneset si kontribues dhe përfitues të këtij shërbimi. Për të nxitur zhvillimin e disa kategorive të bizneseve, si dhe duke ju referuar nivelit ekonomik-social sipas zonave, ngarkesa e tarifimit është shpërndarë gjithashtu duke u bazuar edhe në:

- vendndodhjen (zonë urbane apo zonë rurale),
- llojin e aktivitetit (tregti, shërbim, prodhim, profesion i lirë, fermer, transport, ndërtim, karburant, institucion, ofr, etj)
- në statusin e subjektit (familjar, biznes i madh, biznes i vogël, institucion shtetëror, ambulant etj).

Parashikimi në rritje i të ardhurave nga biznesi bazohet në rritjen e tarifës gjatë viteve në vazhdim, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës taksapaguese falë politikave fiskale, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, fokusimit në zona me kapacitete të pashfrytëzuara, si dhe sensibilizimin dhe trajtimin e biznesit si partner në dhënien e shërbimeve për komunitetin.

Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve publike për pastrimin e largimin e mbetjeve, gjelbërimin, ndriçimin publik

Tarifa për shërbimet publike i prek të dy kategoritë si familjarë ashtu dhe biznes. Tarifat familjare dhe për biznes për pastrim, ndriçim, dhe gjelbërim do të shlyhen nga taksapaguesit në bazë të faturës së gjeneruar nga drejtoria e taksave vendore. Bashkia Mirditë ka bërë të mundur shtimin e shërbimeve për banorët vendas. Shtimi i shërbimeve për mbejtet dhe ndriçimin dhe mirëmbajtja e rrugëve të ndryshme të fshatrave, çon në rritjen e kostos së tyre dhe një nga mënyrat që këto shërbime të mbahen në nivelin e duhur, është rritja e tarifave për vitet në vazhdim. Për vitin 2026 është bërë rikategorizim i llojit të subjekteve për tarifën e pastrimit. Ky kategorizim ndihmon në saktësimin parashikimit mbi tarifën e pastrimit.

Të ardhura nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit

Bazuar në VKM Nr. 970, dt 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", ky zë parashikon rritje



të të ardhurave (edhe pse jo në vlera të konsiderueshme) për arsye të rinovimit të licencave ekzistuese.

Të ardhura nga Tarifat e shërbimeve të mbrojtjes nga zjarri

Të ardhurat e parashikuara me rrije bazohen në nivelin e tarifave të shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridik e fizik, vendas e të huaj, si dhe në realizimin e të ardhurave vitet e kaluara nga kjo strukturë. Ky zë të ardhurash është përfshirë në tabelën e parashikimit të kategorisë të ardhura sekondare.

Të ardhura nga Tarifa e parkimit për mjetet e licencuara dhe për vendparkime publike

Të ardhurat e planifikuara nga tarifa e parkingut për mjetet që kanë bizneset dhe u shërbejnë biznesit të tyre ka patur ndryshim në paketën fiskale 2026 në 20,000 lekë për parkingun në shërbim të biznesit. Në vitin 2026 studimi i hapësirave të parkingjeve do bëhet i mirëstudiuar nga Drejtoria e Zhvillimit të Territorit për të mos krijuar ndërç në shërbimet e bizneseve të tjera, apo qoftë dhe për të mos penguar lëvizjen e qytetarëve. E ardhura nga kjo tarifë, varet nga raporti i studimit për parking. Nqs numri i parkingjeve të miratuara mbetet në të njëjtat shifra, nuk kemi ndryshim të ndjeshëm në tarifën për parking, pavarësisht uljes së tarifës nga 25,000 lekë në 20,000 lekë.

Të ardhura nga tarifat për veprimtaritë në institucione të arsimit, kulturës, sportit, shërbimit social etj.

Të ardhurat nga këto tarifa parashikohen kryesisht të mbulojnë kostot administrative të shërbimeve që përkatësisht këto institucione të kulturës, sportit, e arsimit realizojnë. Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar kapaciteteve të këtyre institucioneve, si dhe realizimit ndër vite. Përsa i përket arsimit, për tarifën e kopështit dhe çerdhes nuk parashikohet një rritje e tyre si pasojë e uljes së numrit të lindjeve dhe largimit të familjeve nga Mirdita. Për vitet 2026-2029 (gjithmonë duke u bazuar në zhvillimin ekonomik dhe nr e popullsisë gjatë viteve), pritet që lehtësirat e miratuara me paketën fiskale në vitin 2025 të kenë ndikim pozitiv sado të vogël si në lehtësimin e jetesës së familjarëve, gjithashtu në arkëtimin e atyre detyrimeve në vlera drejt totalit 100%.



Të ardhura të tjera

Në këtë kategori të ardhurash janë të përfshira të gjithë të ardhurat e tjera si psh të ardhurat nga kamatëvonesat, gjobat e IMT, nga therja e bagëtive, të ardhura që lindin nga shërbime të perkohshme që Bashkia Mirditë kryen etj. Siç është e paraqitur dhe në tabelën e vlerësimit financiar më sipër, parashikohet një rritje jo me vlera të larta. Kjo për arsye se mendohet të kemi një sensibilizim të pagesave në kohën e duhur dhe të uljes së zërit të kamatëvonesave dhe gjobave të ndryshme.

Efekti ekonomik i uljes së nivelit të taksës së pronës nga përjashtimet

Nr	Lehtësimi fiskal	Njësi	Lekë/Njësi	Të ardhurat potencia	Të ardhurat e planifikuara	Efekti financiar
1	Pastrimi nd ekonomike	270	1,000	270,000	405,000	-135,000
2	Pastrimi pensionistë	353	1,000	353,000	529,500	-176,500
3	Ndriçimi nd ekonomike	270	-	-	54,000	-54,000
4	Ndriçimi pensionistë	353	-	-	70,600	-70,600
5	Gjelbërimi nd ekonomike	270	-	-	54,000	-54,000
6	Gjelbërimi pensionistë	353	-	-	70,600	-70,600
7	Ndërtesa nd ekonomike Rrëshen	142	-	-	199,794	-199,794
8	Ndërtesa nd ekonomike Rubik	19	-	-	18,713	-18,713
9	Ndërtesa pensionistë Rrëshen	282	-	-	396,774	-396,774
10	Ndërtesa pensionistë Rubik	71	-	-	69,928	-69,928
						-1,245,909


Bashkia Mirditë ka synuar mbajtjen e taksave në nivele të ulëta, deri në kufijtë e lejuar ligjor. Kështu, taksa e banesës dhe e ndërtesave për qëllime biznesi është ulur 30% në Njësitë Administrative. Tabela e mësipërme paraqet efektin financiar nga përjashtimet e bëra për kategorinë familjare për vitin 2026. Bëjmë me dije se ky efekt është i paraqitur në planin e pritshëm për vitin 2026.

Cash Flow (Fluksi Monetar mujor) i të ardhurave të veta

Falë fokusimit për zgjerimin e vazhdueshëm të bazës taksapaguese, evidentimit të kapaciteteve, ndjekjes së hapave ligjorë ndaj subjekteve debitoare, etj., të ardhurat parashikohet të ruajnë një nivel konstant të arkëtimeve, duke siguruar kështu plotësimin buxhetor dhe fluiditetin e nevojshëm financiar në ushtrimin e funksioneve të veta të bashkisë. Referuar arkëtimeve të viteve të kaluara, për vitin 2025 nivelet më të larta të arkëtimit janë arkëtuar në muajin Qershor dhe Korrik, gjithashtu dhe Tetor, Nëntor, Dhjetor. Këto janë periudhat ku janë të ndara dhe afatet e kësteve të pagesave të në faturat për arkëtim.

Muaj	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
%	6,3	13	15,8	25,3	29,4	39,3	48,3	52,7	54	63,9	68,7	75,3

Cash Flow grafikisht



I njëjti trend pritet të jetë dhe në vietet në vazhdim 2026-2029.

Përgatiti:

Edisnajda Vuka – P/Sektori

Vjollca Gjoka – Dr/Zhv.Ekon.

Miratoi:

KRYETARI

Albert MËLYSHI



ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel & fax : +355 216 22233

web: www.bashkiamirdite.gov.al